

## Përmbajtja

1.	VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM.....	4
1.1.	SITUATA E NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE .....	4
1.2.	ÇËSHTJE KRYESORE PËR PROJEKTET DHE POLITIKAT E BASHKISË.....	4
1.3.	ORIENTIMI AFATGJATË I BASHKISË .....	5
1.3.1.	Strategjia e zhvillimit afatgjatë/ strategjia e personelit.....	5
1.4.	Baza ligjore për hartimin e raportit të egzekutimit të buxhetit.....	7
1.5.	Projektet e investimeve me financim të brendshëm dhe me financim të huaj .....	7
1.6.	Ndryshimet e buxhetit .....	8
1.7.	Çështje të barazisë gjinore.....	9
1.8.	Opinione të auditit të brendshëm dhe të jashtëm .....	9
2.	INFORMACION FINANCIAR .....	19
2.1.	REALIZIMI I TË ARDHURAVE.....	19
2.2.	SHPENZIMET .....	24
2.2.1.	Shpenzimet buxhetore sipas natyrës ekonomike .....	27
2.2.2.	Analiza e detajuar e shpenzimeve sipas programeve buxhetore dhe treguesve të monitorimit të buxhetit .....	28
	Programi Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi .....	28
	Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit .....	30
	Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit .....	30
	Projektet e Investimeve të Programit.....	31
	Të Dhëna mbi Programin .....	31
	Programi Shërbimet e Policisë Vendore .....	32
	Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit .....	33
	Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit .....	34
	Të Dhëna mbi Programin .....	34
	Programi Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile.....	34
	Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit .....	36
	Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit .....	36
	Projektet e Investimeve të Programit.....	37
	Të Dhëna mbi Programin .....	37
	Programi Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.....	37
	Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit .....	39

Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit .....	39
Projektet e Investimeve të Programit.....	40
Të Dhëna mbi Programin .....	40
Programi Administrimi i pyjeve dhe kullotave.....	40
Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit .....	42
Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit .....	42
Të Dhëna mbi Programin .....	43
Programi Rrjeti rrugor rural .....	43
Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit .....	45
Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit .....	45
Projektet e Investimeve të Programit.....	45
Të Dhëna mbi Programin .....	45
Programi Zhvillimi i turizmit.....	45
Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit .....	47
Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit .....	47
Të Dhëna mbi Programin .....	48
Programi Shërbime publike vendore .....	48
Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit .....	50
Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit .....	51
Projektet e Investimeve të Programit.....	52
Të Dhëna mbi Programin .....	52
Programi Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime .....	53
Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit .....	54
Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit .....	54
Programi Sport dhe argëtim .....	54
Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit .....	56
Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit .....	56
Projektet e Investimeve të Programit.....	57
Të Dhëna mbi Programin .....	57
Programi Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore .....	57
Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit .....	59
Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit .....	59
Programi Arsimit bazë përfshirë arsimin parashkollor .....	60

Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit .....	61
Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit .....	62
Projektet e Investimeve të Programit.....	62
Të Dhëna mbi Programin .....	63
Programi Arsimit mesëm i përgjithshëm.....	63
Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit .....	64
Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit .....	65
Të Dhëna mbi Programin .....	66
Programi Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara .....	66
Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit .....	68
Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit .....	68
Projektet e Investimeve të Programit.....	69
Të Dhëna mbi Programin .....	69
2.3. INFORMACIONI FINANCIAR SUPLEMENTAR .....	69
2.3.1. Treguesit Financiarë.....	69

# 1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

## 1.1. SITUATA E NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE

Bashkia e Gjirokastrës kufizohet në veri me bashkinë Tepelenë, në lindje me Bashkinë Libohovë, në jug me bashkinë Dropull dhe në perëndim me bashkitë Himarë dhe Delvinë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Gjirokastrës.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia ka një popullsi prej 25.301 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrit Civil ajo numëron 52.054 banorë. Bashkia shtrihet në një sipërfaqe prej 469.25 km<sup>2</sup>, me një densitet prej 53.91 banorë/km<sup>2</sup> sipas Censurit 2011 dhe 110.93 banorë sipas Regjistrit Civil

Të dhëna të tjera: Bashkia e re e Gjirokastrës do të përbëhet nga qyteti i Gjirokastrës, i cili prej vitit 2005 ndodhet në listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s si dhe zonat rurale kodrinore përreth, të përqendruara më së shumti te prodhimet blegtorale.

Gjirokastra është një qytet tregtar i stilit otoman, ndër të paktët të tillë të mbijetuar në Ballkan. Qyteti ka mbi 800 ndërtesa historike, shumë prej të cilave rrezikohen nga degradimi. Katet përdhese të shtëpive karakteristike shërbenin si struktura mbrojtëse edhe depo të shtëpive.

Kostumet lokale të Gjirokastrës janë tradicionalisht të zbukuruar me qëndisma të komplikuar. Po ashtu prodhohen në mënyrë artizanale qilima e velenxa, triko, çorape e doreza. Të famshme në të gjithë vendin janë dantellat e Gjirokastrës; punime me grep dhe qëndismat. Ndërsa burrat përpunojnë drurin dhe gurin. Veshjet tradicionale popullore të grave zbukuroheshin me fije metalesh të çmuara si kostumet e famshme të grave të Lunxhërisë. E integruar në Iso-polifoninë shqiptare, ajo është njohur më 2005 nga UNESCO si “trashëgimi kulturore e paprekshme”.

Burimet kryesore të ekonomisë urbane në Gjirokastër janë turizmi dhe manifaktura me material porositës, e cila shërben përgjithësisht për tregun grek dhe që gjatë viteve të fundit është goditur rëndë për shkak të krizës në Greqi.

## 1.2. ÇËSHTJE KRYESORE PËR PROJEKTET DHE POLITIKAT E BASHKISË

Bashkia Gjirokastër ushtron funksionin e saj në zbatim të Planit të Përgjithshëm Vendor të cilat janë si më poshtë:

Politikat e PPV për sistemin bujqësor parashikojnë ruajtjen, konsolidimin dhe modernizimin, si :

- -Mbrojtjen maksimale të tokës bujqësore duke propozuar densifikimin e zonave urbane.
- -Krijimi i një zinxhiri ekonomik bujqësor që nga prodhimi, grumbullimi, përpunimi e tregtimi (treg rajonal bujqësor). Nevojitet bashkëpunimi i fermerëve.
- Uja e koston së produkteve dhe shtimi i investimeve për modernizimin e teknologjisë dhe infrastrukturat përkatëse. Krijimi i rrjetit të kanaleve vaditëse e kulluese për tokat bujqësore.
- -Sinergjia me sektorë të tjerë, si p.sh. turizmi, transporti, energjia.

- -Krijimi i Poleve Bujqësore dhe specializimi sipas rastit. Gjirokastra ka afër polin e propozuar bujqësor të Sarandës, nga i cili mund të përfitojë.
- Çertifikimi i produkteve karakteristike vendase dhe specializimi në prodhimi dhe përpunim (si bimët mjekësore, pemët frutore, ullishtet, vreshtat, produkte bujqësore). Prodhimi i produkteve bio (organike) dhe nxitja e funksionimit të fermave do të rriste konkurrueshmërinë e këtyre produkteve në rajon. Për sistemin ujor propozohen politikat për:
  - Përdorimin racional dhe i qëndrueshëm i burimeve ujore.
  - -Përmirësimi i teknologjive dhe jo përdorim intensive i burimeve ujore.
  - Uljen e mbetjeve të prodhuara.
  - Ruajtjen e biodiversitetit dhe ekosistemeve natyrore.
  - Plotësimin e nevojave për përdorimin e ujit të pishëm, në bujqësi dhe për prodhim energjie. Menaxhimin e qëndrueshëm të këtyre kërkesave. Hartimi i planeve të menaxhimit të trupave ujorë (veçanërisht baseni i lumit Vjosa).
  - Mbrojtjen e burimeve ujore përmes përcaktimit të Vijës Blu nga përdorimet e ndaluara dhe shfrytëzimi privat (200 m nga bredgeti, 100 m nga lumi, 1 km nga korridoret natyrore). Të trajtohet si zone e mbrojtur dhe mbi të të respektohet legjislacioni në fuqi.
  - Pajisjen me impiant të trajtimit të ujërave të ndotur të qendrave parësore e dytësore (minimalisht 1).
  - Mbulimi i plotë i zonave turistike e suburbane me shërbimin e ujësjellës-kanalizimeve. - - Krijimin e itinerareve lumore-liqenore.

### 1.3. ORIENTIMI AFATGJATË I BASHKISË

#### 1.3.1. Strategjia e zhvillimit afatgjatë/ strategjia e personelit

Për të përmbushur vizionin për Bashkinë e Gjirokastrës janë zhvilluar 5 objektiva strategjike, të cilat do të udhëheqin zhvillimin në të gjithë territorin e Bashkisë për vitet në vijim. Këto objektiva paraqiten si më poshtë vijon:

**Objektivi Strategjik 1:** Forcimi i pozicionit kyç të Bashkisë, për tu bërë porta jugore e vendit dhe nyje për bashkëpunimin ndërkufitar. Duke forcuar në të njëjtën kohë rolin e Gjirokastrës si një qendër e turizmit rajonal dhe portë drejt destinacioneve turistike të vendit, por edhe qendër shërbimi/mbështetje të zhvillimit turistik bregdetar. Duke marrë parasysh faktin se Bashkia ka një pozicion gjeografik kyç, përbën një kanal komunikim midis zonës bregdetare dhe qyteteve në brendësi të vendit, ndërsa ndodhet afër kufirit jugor kombëtar pasi autostrada SH4 është pjesë e Rrjetit Kryesor të Europës Juglindore dhe të zgjerimit të rrjetit qendror të transportit ndër-evropian në Europën Juglindore. Gjithashtu, vlen për t'u përmendur edhe afërsia me Greqinë, me rrjetin rrugor cilësor të rrugës Egnatia, por edhe më portin e Igumenicës dhe aeroportin rajonal të Janinës. Të gjitha këto e bëjnë pozicionin e saj kyç dhe duhet të ketë fuqizim në këtë drejtim. Në të njëjtën kohë, siç propozohet edhe nga PINS\_Bregdeti, duhet të forcohet roli i Gjirokastrës si një qendër mbështetëse për zhvillimin turistik bregdetar.

**Objektivi Strategjik 2:** Mbrojtja dhe promovimi i mjedisit kulturor të Bashkisë dhe të trashëgimisë kulturore (numër i madh vendesh më interes historik dhe kulturor, qyteti i vjetër i Gjirokastër- monument

UNESCO), me qëllim rivitalizimin turistik të rajonit. Në bazë të të dhënave të analizës, Bashkia Gjirokastrë është një bashki me mjedis të pasur kulturor dhe trashëgimi interesante kulturore. Pra, në këtë bashki gjenden një numër i madh vendesh me interes historik dhe kulturor, si në qytetin e Gjirokastrës edhe në vendbanimet e tjera, kryesisht në ato që ndodhen në shpatin e malit Lunxhëri. Gjithashtu, një pikë e fortë e bashkisë është karakterizimi i bërë nga UNESCO, si një monument kulture i trashëgimisë botërore. Për të gjitha arsyet e përmendura më sipër Gjirokastra përbën tashmë një destinacion kombëtar dhe ndërkombëtar turistik. Një objektiv i rëndësishëm për zhvillimin e Bashkisë, përbën promovimi i mjedisit kulturor të lartëpërmendur, me synim rivitalizimin e turizmit në këtë zonë. Përveç qytetit të Gjirokastrës, duhet të bëhet promovimi edhe i fshatrave rajonale në të cilat në shumë raste është vërejtur mungesa e zonave kulturore.

**Objektivi Strategjik 3:** Rigjenerimi ekonomik i zonës, i udhëhequr nga parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, në përmjet zgjerimit të bazës prodhuese dhe të zhvillimit të balancuar të tre sektorëve të prodhimit. Për Bashkinë e Gjirokastrës, objektivi i parë strategjik, lidhet kryesisht me rigjenerimin e turizmit në rajon, e cila siç e konstatojmë si gjatë fazës së parë të studimit por edhe gjatë analizës së thelluar SËOT që u realizuar më lart, ka element të rëndësishëm historik dhe kulturor, të cilat duhet të mbrohen dhe promovohen. Për më tepër, qyteti i Gjirokastrës, pritet që të bëhet një atraksion turistik nëpërmjet shfrytëzimit të mjedisit kulturor dhe krijimit të një identiteti të fortë (brand name). Përveç sektorit të turizmit, Bashkia e Gjirokastrës siguron prodhime të rëndësishme bujqësore dhe aktivitet industrial, sektorë të cilët duhet gjithashtu të stimulohen. Prodhimi bujqësor është veçanërisht i rëndësishëm, duke marrë parasysh pozicionin e saj, përshkimin e Bashkisë nga lumi Drino dhe tokat bujqësore afër tij kanë produktivitet të lartë. Në të njëjtën kohë ka edhe një sektor të fuqishëm industrial i cili është përqëndruar kryesisht përgjatë autostradës SH4 dhe do të duhet të këtë organizimin e duhur për përdorimin e tokës në mënyrë që të mos ketë konflikte të përdorimit të tokës dhe njëkohësisht të stimulohet sektori në fjalë. Fuqizimi i këtyre tre sektorëve të prodhimit do të çojë në promovimin e Bashkisë si një destinacion kombëtar dhe ndërkombëtar, në shfaqjen e Gjirokastrës si një atraksion të trashëgimisë ndërkombëtare, në krijimin e vendeve të reja të punës dhe si rezultat i saj në reduktimin e papunësisë, në forcimin e aftësisë konkurruese të Bashkisë, në rivitalizimin e popullsisë dhe në ruajtjen dhe tërheqjen e popullsisë së re.

**Objektivi Strategjik 4:** Mbrojtje dhe menaxhim i qëndrueshëm i mjedisit natyror, nëpërmjet evidentimit të elementëve të fortë të Bashkisë (zona e mbrojtur Kardhiq, monumente natyrore, sipërfaqe pyjore) dhe mbrojtje si e sistemeve të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore (burime, lumi Drino, liqeni Viroi), edhe të sistemit të tokës natyrore dhe bujqësore nga aktivitetet njerëzore. Duhet ti jepet rëndësi mjedisit natyror të Bashkisë. Është një bashki që ka element të rëndësishëm të mjedisit natyror (zona e mbrojtur Kardhiq, monumente natyrore të mbrojtura, sipërfaqe interesante pyjore) si dhe elementë të sistemeve ujore (lumi Drino, liqeni Viroi, numër i konsiderueshëm burimesh), për të cilat duhet të sigurohet mbrojtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm. Duhet të realizohen projektet e duhura për të marrë masa për eliminimin e problemeve që krijohen nga ndërhyrjet njerëzore, të tilla si depozitimi i pakontrolluar i mbeturinave dhe mbetjeve urbane në lumin Drino, presioni ndaj akuiferit për shkak të nevojave për ujë dhe ujitje, gërryerja e rrërës dhe nxjerrja e materialeve të ngurta, vendosja e varrezave në kontakt me rrjedhat, etj.

**Objektivi Strategjik 5:** Përmirësimi i cilësisë së jetës së banorëve, nëpërmjet përmbushjes së infrastrukturës teknike dhe krijimit të një niveli të lartë të infrastrukturës sociale. Paralelisht duhet të jepen mundësi më të mira punësimi dhe të ketë një rigjallërim të qytetit të Gjirokastrës nëpërmjet rigjenerimit urban.

Rol të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së jetesës së banorëve do të ketë fuqizimi dhe përmirësimi i sistemit të infrastrukturës teknike. Fillimisht duhet të reduktohet koha dhe distanca e Gjirokastrës dhe e vendbanimeve të tjera rajonale nga kryeqyteti, Tirana, dhe të eliminohen ato probleme që u konstatuan në disa pjesë të rrjetit rrugor (rrugë të pa asfaltuara, kryqëzime me gjerësi të vogël, rrëshqitjet e tokës), kryesisht në fshatrat malore, të cilat kanë siguri të ulët rrugore. Gjithashtu, duhet të fuqizohet edhe rrjeti i brendshëm rrugor, i cili paraqet shumë probleme për shkak të rritjes së pjerrësisë së tokës. Për sa i përket pjesë tjetër të infrastrukturës teknike, kërkohet krijimi i një Landfill-i, krijimi i infrastrukturës për riciklim, përmirësimi i infrastrukturës së ujësjellësit dhe kthesë drejt burimeve të rinovueshme për energjinë. Sa i përket infrastrukturës sociale, kërkohet të plotësohen nevojat bazë të banorëve të Gjirokastrës por edhe të fshatrave, të ketë mundësi më të mira për punësim dhe strehim dhe në këtë mënyrë të flasim për një nivel jetesë të përmirësuar dhe mundësi më të mira për arsim, shëndetësi, aktivitete kulturore etj. Në Gjirokastër, ku disa nga infrastrukturat sociale ekzistojnë, do të duhet të stimulohen dhe përmirësohen, ndërsa në fshatrat ku mungojnë duhet të parashikohet krijimi i tyre. Në lidhje me strehimin, duhet të ndërmerren masat e nevojshme për mirëmbajtjen e ndërtesave, veçanërisht në vendbanimet rurale me qëllim eliminimin e fenomenit të braktisjes së banesave për shkak të dëmtimeve. Sidomos qyteti i Gjirokastrës, duhet të shndërrohet në një qytet të qëndrueshëm me një mjedis tërheqës, nëpërmjet organizimit të përdorimeve të tokës, rivitalizimit të qendrës historike me anë të ndonjë plani për menaxhimin për ripërdorimin e ndërtesave në qendër, shtimit të vendeve të përbashkëta publike dhe krijimit të vendeve të organizuara të parkimit.

#### 1.4. Baza ligjore për hartimin e raportit të egzekutimit të buxhetit

Realizimi i buxhetit të vitit 2021 është bërë në përputhje me ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 64; ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; ligjin nr. 68 datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"; ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; ligjin 137/2020 "Për buxhetin e vitit 2021"; Udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njëjësive të qeverisjes vendore"; nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"; nr. 4 datë 25.01.2021 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021" të MFE-së; dhe VKB 141, datë 28.12.2020 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2021-2023" të ndryshuar.

1.5. Projektet e investimeve me financim të brendshëm dhe me financim të huaj  
Projektet kryesore të investimeve të realizuara gjatë vitit 2021, paraqiten në tabelën më poshtë:

Kodi programit	Programi	Emri i projektit	Vlera e plote e projektit	Fillon	Mbaron	Plan i rishikuar	Fakt
----------------	----------	------------------	---------------------------	--------	--------	------------------	------

04240	Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	Rikonstruksioni i kanalit vaditës	10276			10276	3967
04520	Rrjeti rrugor rural	Rikonstruksioni i rrugices "Kapo Baco" ne lagjen Varosh	8021	2019	2019	4668	3301
04520	Rrjeti rrugor rural	Rikonstruksioni i rrugës Zeman Haska	28411			27819	23624
06260	Shërbime publike vendore	Rikualifikimi I hapësirave publike rreth stadiumit Gjirokastër	32272			16259	16000
06260	Shërbime publike vendore	Riveshje ne segmente te ndryshme rruge	5134			5134	4804
06260	Shërbime publike vendore	Blerja e konteniervë	6924			6924	6242
08130	Sport dhe argëtim	"Rikonstruksioni i godinave dhe ambienteve sportive (fusha e vjetër dhe pallati sportit)	5423	2020	2020	5423	4632
09120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	Rikonstruksion i godinave dhe ambienteve të institucioneve arsimore "Urani Rumbo" dhe "Bilal Golemi"	5117	2020	2020	4191	4112

## 1.6. Ndryshimet e buxhetit

Gjatë vitit 2021 janë bërë disa rishikime buxhetore për të akomoduar nevojat për realizimin e objektivave të vendosura nga bashkia gjatë këtij viti.



## 1.7. Çështje të barazisë gjinore

Barazia mes grave dhe burrave përbën një të drejtë themelore për të gjithë. Autoritetet vendore përfaqësojnë nivelet më afër njerëzve, ndaj kemi përgjegjësi të drejtëpërdrejtë që me veprimet dhe politikat tona të nxisim proçese që promovojnë një shoqëri të barabartë.

Ne, jemi të vetëdijshëm që përqafimi i konceptit të barazisë është një tregues i spikatur i një qeverisjeje të mirë. Ndaj, sot Bashkia Gjirokaster i kushton vëmendje të veçantë nxitjes për barazinë gjinore. Në këtë kuadër, Bashkia Gjirokaster ka ndërmarrë disa nisma për të nxitur përfshirjen demokratike dhe të barabartë të burrave dhe grave, djemve dhe vajzave në proçese të ndryshme vendimmarrjeje dhe përfaqësuesimi si dhe ka ndjekur politika sociale për përkrahjen e tyre në mënyrë të barabartë. Aty ku ka qenë e mundur, Bashkia Gjirokaster ka përcaktuar edhe tregues performance me bazë gjinore, të cilat paraqiten në programet përkatëse buxhetore që shtjellohen në këtë dokument.

## 1.8. Opinione të auditit të brendshëm dhe të jashtëm

Gjatë vitit 2021. Në bashki janë zhvilluar auditime, nga të cilat auditime nga njësia e auditimit të brendshëm dhe auditime nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Nga auditimi i zhvilluar nga njësia e auditimit të brendshëm të bashkisë janë lënë rekomandimet e mëposhtme si dhe janë marrë masat për adresimin e tyre nga bashkia, siç përshkruhet më poshtë:

**1.Rekomandojmë:** Nga ana e Drejtorisë së Shërbimit Social dhe Shëndetsorë Bashkia Gjirokastër , në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore , të meren masa për vënien në efikasitet të rregullores së brendshme. **(Në vazhdimësi , Drejtorisë së Shërbimit Social dhe Shëndetsorë, Bashkia Gjirokastër , në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore).**

**2.Rekomandojmë:** Nga ana e Drejtorisë së Shërbimit Social dhe Shëndetsorë Bashkia Gjirokastër , në bashkëpunim dhe me Drejtorinë e Finacës në Bashkinë Gjirokastër , të kryejnë një planifikim real në lidhje me buxhetin për vitin pasardhës.**(Në vazhdimësi , Drejtorisë së Shërbimit Social dhe Shëndetsorë Bashkia Gjirokastër , në bashkëpunim me Drejtorinë e Finacës në Bashkinë Gjirokastër).**

**3.Rekomandojmë:** Nga ana e Drejtorisë së Shërbimit Social dhe Shëndetsorë Bashkia Gjirokastër , të njihet zyrtarisht Kryetari i Bashkisë në lidhje kushtet që duhet të kenë ambientet infrastrukturore , sipas Nenin 13 i Ligjit 7889 datë 14/12/1994 (ndryshuar me ligjin nr.8052, datë 21.12.1995, nr.9143, datë 16.10.2003) , i cili shprehet se **“Mjediset e institucioneve shëndetësore, të përkujdesjes shoqërore dhe ato publike përshtaten për përdorimin e tyre nga të verbrit dhe paraplegjikët”** .**(Në vazhdimësi , Drejtorisë së Shërbimit Social dhe Shëndetsorë Bashkia Gjirokastër , në bashkëpunim me Drejtorinë e Finacës në Bashkinë Gjirokastër).**

**4.Rekomandojmë:** Nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerzore të meren masa për vënien në efijencë të rregullores së brendshme , ku të jenë të specifikuara detyrat dhe detyrimet e Njësie Administrative.(**Në vazhdimësi Drejtorisë së Burimeve Njerzore**).

**5. Rekomandojmë:** Nga ana e specialisteve të protokollit në Njësitë Administrative , Picar , Odrie , Cepo dhe Lunxhëri , të mbahen librat e protokollit në mënyrë të rregullt dhe pa korigjime, (**Në vazhdimësi Njësitë Administrative , Picar , Odrie , Cepo dhe Lunxhëri**).

**6. Rekomandojmë:** Njësitë Administrative të kenë një Kordinim zyrtar me Drejtorinë e Tatimë Taksave dhe Liçensave në lidhje me Debitorët e ndryshëm të evidentuar në Bashkinë Gjirokastër, (**Në vazhdimësi Njësitë Administrative** ).

**7. Rekomandojmë:** Nga ana e Administratorëve në Njësitë Administrative Picar , Lunxhëri dhe Antigone , ti bëhen zyrtarisht të ditura , problematikat e ndryshme që hasen në këto njësi , duke formuluar një plan , kryesisht për investimet prioritare , ku të parashtrihen , kërkesat më emergjente dhe prioritare që mund të kenë Njësitë Administrative , duke patur si prioritet , shërbimin në interes të përgjithshëm publik , të cilat ofrohen nga bashkia për komunitetin, (**Në vazhdimësi Njësitë Administrative , Picar , Antigone dhe Lunxhëri**).

**8. Rekomandojmë:** Në të gjitha Njësitë Administrative , të ndiqen procedurat sipas pikës (ë) të nenit 66 , të ligjit 139/2015 datë 17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” për vendosjen e emërtimeve të rrugëve me qëllim pasjen e adresave të sakta dhe në Njësitë Administrative, (**Në vazhdimësi Njësitë Administrative**).

**9. Rekomandojmë:** Të zbatohet me rigorozitet , nenin 15 i ligjit 10296 datë 08/07/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin “ , pika 62 dhe 68 e udhëzimit Nr.30 datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Sektorin Publik” si dhe të meren me proces verbal të rregullt sipas numrit serjal , blloqet e mandate arkëtimeve, (**Në vazhdimësi Njësitë Administrative** ).

**10.Rekomandojmë:** *Për vitin pasardhës nga ana e Drejtorisë së MZSH-së dhe në veçanti nga ana e punonjsit (economist) të shërbimit vendor të MZSH-së të kryhet një planifikim real dhe serioz i buxhetitsi dhe të ndiqen me perparësi përdorimi i këtyre fondeve të planifikuara.*

**11.Rekomandojmë:** *Nga ana e punonjësit të Informacionit në MZSH-në Bashkia Gjirokastër, të kryhet rregjistrimi në librin përkatës , i të gjitha veprimeve dhe lëvizjeve të kryera nga ana e forcave dhe mjeteve dhe të njoftojë drejtuesin e Stacionit për këto zhvillime.*

**12.Rekomandojmë:** *Gjithashtu për rastet kur automjetet e MZSH-së , janë të detyruar të lëvizin për arsye të ndryshme të cilat nuk janë në funksion të misionit që ka stacioni i MZSH-së, nga ana e Shefit të Sektorit të ndërhyrjes dhe punonjsit (economist) të shërbimit vendor të MZSH-së, duhet të plotësohet dokumentacioni sipas kërkesave përkatëse) si dhe Ligjin nr.25/2018, “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat*

*Financiare “ , kreu II, pika 1 e nenit 7 si dhe pikat 35/c ; 36 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30 datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”ku fletët e udhëtimit të jenë të shoqëruar me Uedhrin e titullarit, autorizimin , dhe arsyetimin. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë si dhe atë të mashtrimeve).*

**13.Rekomandojmë:** *Të bëhet abdejtimi dhe plotësimi i dokumentacionit të dosjeve të personelit të MZSH-së për të gjitha nivelet , e konkretishtë ;*

*(a) për nivelin e lartë në respektim të pikave 4/2 ; 4/3 të nenit 64 si dhe pikës (e) te nenit 39, të, VKM Nr.520 datë 25.07.2019”Për miratimin e rregullores për shpëtimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit” të ndiqen procedurat për sa më sipër, pasi në dosje mungonte rifreskimi i çertifikatës mjeksore deshmia e aftësisë së drejtimit të automjetit sipas vendit të punës , kontrata individuale e punës , vërtetim vendbanimi si dhe vlersimi i punës, i firmosur nga Kryetari i Bashkisë.*

*(b) për nivelin e mesëm në respektim të neneve 39; 42 ; 44 ; 45 dhe 64 të, VKM Nr.520 datë 25.07.2019”Për miratimin e rregullores për shpëtimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit”, të ndiqen procedurat për sa më sipër, pasi në disa prej dosjeve mungonte çertifikata mjeksore, dëshmia e aftësisë së drejtimit të automjetit sipas vendit të punës , vërtetim vendbanimi, kontrata individuale e punës dhe çertifikata familjare, informacioni nga strukturat vendore te policise se shtetit per personalitetin e aplikantit per rekorde te mundshme kriminale , testimet me shkrim , testimi i aftësisë fizike , intervista me gojë testimi psikologjik dhe verifikimi perfundimtar i aplikantit .*

*(c) për nivelin bazë në respektim të pikave të nenit 64 të, VKM Nr.520 datë 25.07.2019”Për miratimin e rregullores për shpëtimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit” të ndiqen procedurat për sa më sipër, pasi në dosjen e personelit kishte mangësi në rifreskimi i çertifikatës mjeksore, deshminë e aftësisë së drejtimit të automjetit sipas vendit të punës , vërtetim vendbanimi, kontratave individuale të punës. Si dhe në një rast, në kundërshtim me ligjin Nr 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”i ndryshuar, ka qënë Kryetar komisionit të aktit të vlersimit të grades Drejtuesi i MZSH-së .*

**14.Rekomandojmë:** *Nga ana e Shefit të Ndërhyrjes dhe Stërvitjes në Drejtorinë e Shërbimit të MZSH-së në Bashkinë Gjirokastër, të bëhet evidentimi për çdo demtimi të automjeteve, paisjeve dhe materialeve të tjera në përdorim , duke përcaktuar shkakun dhe personat përgjegjës .*

**15.Rekomandojmë:***Nga ana e drejtuesit të MZSH-së të ndiqet zyrtarishtë , procedura për relatimin dhe miratimin në Këshillin Bashkiak të Vendimit ku të përcaktohet Struktura, Uniforma dhe Shenjat dalluese të veçanta, të punonjësit të shërbimit vullnetar të MZSH-së.*

**16.Rekomandojmë:***Në zbatim të Rekomandimeve të dhëna nga ana e Njesisë së Auditimit të Brëndshëm në Bashkinë Gjirokastër, si dhe Udhëzimit Nr.42 datë 27/10/2020”Mbi*

ndjekjene e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik', të zbatohen detyrat e lëna nga auditimet e mëparshme, e konkretishtë :

- Të respektohet afati ligjor 3 mujor nga data e marrjes te Raportit Perfundimtar te Auditimit, mbi dhenien e informacionit nga subjekti i audituar, mbi monitorimin ecurine dhe progresin qe eshte bere per zbatimin e rekomandimeve,
- Të ketë një plan veprimi për realizimin e rekomandimeve per masa me karakter organizativ, duke pasqyruar punene e bere te analizuar per rekomandimet e realizuara plotesisht, pjeserisht, ne proces realizimi si dhe sa nga rekomandimet e lëna nuk jane pranuar.
- Të evidentohen të dhënat teknike të mjeteve, defektet e konstatuara, shërbimet e kryera periodike etj

**17.Rekomandojmë:** Për vitet ne vazhdim nga ana e Drejtorisë së Arsimit në bashkpunim me Drejtorinë e Finances të kryhet një planifikim real dhe serioz i buxhetit si dhe të ndiqen me perparësi përdorimi i këtyre fondeve të planifikuara

**18.Rekomandojmë:** *Nga ana e Drejtorisë së Arsimit të meren masa të menjëhershme në përputhje me legjislacionin në fuqi me Ligjin nr.25/2018, "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare " , kreu II, pika 1 e nenit 7 si dhe pikat 35/c ; 36 të Udhezimit të Ministrisë së Financave nr.30 datë 27/12/2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" ku fletët e udhëtimit të jenë të shoqëruar me Urdhrin e titullarit, autorizimin , dhe arsyetimin. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, si dhe te jene te firmosura nga urdheruesi.*  
Gjithashtu nga ana e Drejtorise të merren masa per ngritjen e grupit të punes për matjen e normativës së harxhimit të karburantit (naft),

**19.Rekomandojmë:** *Nga ana e Drejtorisë së Arsimit të meren masa të menjëhershme në përputhje me legjislacionin në fuqi me Ligjin nr.25/2018, "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare " , kreu II, pika 1 e nenit 7 si dhe pikat 35/c ; 36 të Udhezimit të Ministrisë së Financave nr.30 datë 27/12/2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" ku te dokumentohet ndezja e kaldajave gjatë periudhës së dimrit sipas grafikut të ndezjes ora e ndezjes se kaldajes , ora e fikjes , data e ndezjes , harxhimi per ore dhe dite të lëndë djegëse. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, si dhe te jene te firmosur nga punonjësi i ndezjes se kaldajeve si dhe nga Titullari i institucionit arsimore .*

**20.Rekomandojmë:** Nga ana e asistententeve të Drejtorise se Arsimit të behet i mundur rakordim midis shkresave te ardhura nga drejtorite e kopshteve, cerdheve dhe konviktit me dokumentacionin e arkës së Drejtorisë Arsimore si dhe rakordim midis arkës në lidhje me të ardhurat (kopshtet,cerdhe, konvikti) me pasqyrat e magazines për nxjerrjen e kuotes ushqimore.

**21.Rekomandojmë:** Drejtoria e arsimit Bashkia Gjirokaster , në bashkpunim me Drejtorinë e Financës , të marin masat për ngritjen e komisionit, për nxjerejen jashtëpërdorimit dhe nga kontabiliteti, të këtyre materialeve te demtuar të cilat kishin vite të amortizuara , sipas procedurave të përcaktuara ne Udhezimin e M.F. , nr.30 datë 27/12/2011 "Për menaxhimin e

aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe Ligjin nr.25/2018, “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare ” .

**22.Rekomandojmë:** Nga ana e Drejtorisë së Arsimit dhe nga Drejtoria e Financës të merren masa për ngritjen e komisioneve të përbashkëta për nxjerejen jashtëpërdorimit dhe nga kontabiliteti, të paisjeve në laboratorët e Informatikës , të aparateve si (kompjuter fotokopje printer) të demtuar të cilat kishin vite të amortizuara, sipas procedurave të përcaktuara në Udhezimin e M.F. , nr.30 datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe Ligjin nr.25/2018, “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare.

**23.Rekomandojmë:** Drejtoria e arsimit Bashkia Gjirokaster , në bashkpunim me Drejtorinë e Financës të kryejn ndarjen e objekteve në varesi të drejtorise arsimore sipas çdo institucioni që ka kjo drejtori në mbikqyrje (kopshte , cerdhe, ambiente sportive , etjer)

**24.Rekomandojmë:** Drejtoria e arsimit Bashkia Gjirokaster , në bashkpunim me Drejtorinë e Financës, për llogarinë 214 e cila përfaqëson makineri pajisje dhe vegla pun , e konkretisht artikullin sistemi i ngrohjes (kaldaja), të pasqyroje në inventarin përkatës vlerën e çdo kaldaje duke kërkuar dokumentacionin e origjines në arshiven e bashkise , arshiven e drejtorise ose në vete institucionet arsimore (kopshte , cerdhe, ambiente sportive , etjer) .

**25.Rekomandojmë:** Drejtoria e arsimit Bashkia Gjirokaster , në bashkpunim me Drejtorinë e Financës, për llogarinë 215 e cila përfaqëson mjetet e transportit, e konkretisht 3 (tre) mjete Kamionin Toyota Hilux 2.4 me targa VL2271B, kamionin Ford me targa BR4217B dhe autoveturë Toyota Landcruiser me targa VL7440B të cilat janë dhënë pa likuiditet dhe janë pa vlerë leku , të pasqyrohen në inventarin përkatës vlerën e çdo automjeti duke kërkuar dokumentacionin e origjines në arshiven e bashkise , arshiven e drejtorise ose në drejtorinë rajonale të transportit rrugor.

**26.Rekomandojmë:** Drejtoria e arsimit Bashkia Gjirokaster , në bashkpunim me Drejtorinë e Financës të marin masat për asgjësimin e elementeve kimik në laboratorët e kimise të cdo institucioni arsimor sipas Udhezimin e M.F. , nr.30 datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” .

**27.Rekomandojmë:** Drejtoria e arsimit Bashkia Gjirokaster , në bashkpunim me Drejtorinë e Financës , të kryhet hedhja e këtyre inventareve me çmimet përkatëse të këtyre pajisjeve sipas Fletë daljes me Nr.50 datë 24/07/2019 të DAR-it Gjirokastër.

**28.Rekomandojmë:** Nga ana e Drejtorisë së Financës, ti kërkohej zyrtarishtë, Drejtorisë së të Ardhurave,, lista e të gjithë debitorëve apo kreditorëve që disponon kjo drejtori dhe më pasë të kryej kontabilizimin përkatës sipas ”ligjit nr.9228, dt.29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar .

**29. Rekomandojmë:** Nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave të bëhet saktësimi dhe sistemimi i saktë i adresës, për çdo subjekt debitor që ka adresë dhe Nipt të njëjtë, por me shuma detyrimi të ndryshme.

**30. Rekomandojmë:** Nga ana e Drejtorisë së Financës ti kërkohej zyrtarishtë IMT-Bshkia Gjirokastër, lista e të gjithë debitoreve/kreditore që disponon kjo drejtori dhe më pasë të kryej kontabilizimin përkatës sipas "ligjit nr.9228, dt.29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar .

**31. Rekomandojmë:** Nga ana e Drejtorisë së Financës ti kërkohej zyrtarishtë Policisë Bashkiake/Bshkia Gjirokastër, lista e të gjithë debitoreve apo kreditore që disponon kjo drejtori dhe më pasë të kryej kontabilizimin përkatës sipas "ligjit nr.9228, dt.29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar .

**32. Rekomandojmë:** Nga ana e Drejtorisë së Financës të bëhet likuidimi sa më parë i kreditoreve duke i planifikuar ata në buxhetin e vitit pasardhës, si dhe në bashkëpunim dhe me Zyren Juridike me anën e korispodencave zyrtare , të evidentohet origjina dhe adresea e atyre kreditorëve, që janë në pasqyrat financiare por që nuk ndodhen në partitarët e pasqyrave financiare, me qëllim vërtetimin e origjinës së lindjes së këtyre kreditorëve.

**33. Rekomandojmë:** Nga ana e Drejtorisë së Financës në bashkëpunim dhe me Zyren Juridike, me anën e korispodencave zyrtare , të kërkojë njoftimin e Drejtorive dhe Njësive në varësi të Bashkisë Gjirokastër, në lidhje me evidentimin e Debitorëve të pa kontabilizuar, të mundshme në këto Drejtori apo Njësi, ndjekjen e procedurave për njoftimin dhe vjeljen e shumave debitore të kontabilizuara, si dhe të evidentohet origjina dhe adresea e këtyre debitoreve, që janë në pasqyrat financiare por që nuk ndodhen në partitarët e pasqyrave financiare, me qëllim vërtetimin e origjinës së lindjes së këtyre debitoreve .

Nga auditimi i zhvilluar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit janë lënë rekomandimet e mëposhtme si dhe janë marrë masat për adresimin e tyre nga bashkia siç përshkruhet më poshtë:

1.Drejtorja e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave të merren masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të pashlyera nga të ardhurat vendore për vitet 2018-2020 në vlerën 125 689 mijë lekë sipas evidencave të Drejtorisë së të Ardhurave Vendore.

2.Drejtorja e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masat e nevojshme për arkëtimin e vlerave debitorë të krijuar gjatë viteve 2018-2020, duke proceduar me kërkesë padi në Gjykatë, në zbatim të kërkesave ligjore si dhe kontabilizimin e gjobave të vendosura nga IMTV-ja në fund të vitit 2020 në vlerën 21 700 mijë lekë.

3. Drejtorja e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të vlerësoj rastet e debitoreve pa shpresë arkëtimi dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për sistemimin e vlerave debitorë.

4. Bashkia Gjirokastrë, nëpërmjet nëpunësit zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe kundërparti 467 “Kreditorë të ndryshëm”.
5. Drejtoria e Financës në mbyllje të vitit Ushtrimor 2021 të kryhen veprimet e sistemimit në kontabilitet të llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” të pasqyrohen në gjendjen kreditore të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në pasiv të bilancit, detyrimet ndaj të tretëve të lindura nga vendimet gjyqësore si dhe nga detyrimet kontraktore të cilave i ka kaluar afati 60 ditor në vlerën 20 078 971 lekë. Gjithashtu, pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura duhet të merren masa për raportimin e tyre në Ministri të Financave, raportim i cili aktualisht nuk është real.
6. Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Gjirokastrë, të kryej veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës së studim-projektiveve sipas investimeve të kryera dhe për cdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura koresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë.
7. Kryetari i bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe drejtoresha e financës në cilësinë e nëpunësit zbatues, të marrin masa për vlerësimin e aktiveve afatgjata material dhe jo material, aktive afatshkurtra, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve duke plotësuar me dokumentacionin mbështetës llogarinë 2015 “Mjete transporti” si dhe ngritjen e një komisioni për vlerësimin e 9 mjeteve të transportit që paraqiten me kosot historike 0 Lekë.
8. Bashkia Gjirokastrë, nëpërmjet nëpunësit zbatues të marrë masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin e aksioneve të “UKGJ” sha me vlerë 137 423 000 Lekë në debit të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe në kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrje me kapitale të veta.
9. Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Shërbimeve, të saktësojnë subjektet dhe fondet për të cilat janë ngurtësuar si garanci për punimet e kryera për të cilat kanë humbur të drejtën e përfitimit të tyre ose që janë kushtet e parashkrimit të së drejtës, në zbatim të kërkesave të pikës 10, kap II të UKM nr 3. datë 15.02.2021 “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar. Drejtoria e Financës, për këtë arsye, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Gjirokastrë për rimarjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.
10. Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me komisionet inventarizues, të analizojë inventarët e paraqitur në fund të vitit 2020 për llog. 218 dhe 32, për saktësinë e vlerës dhe sqarimin e mospërputhjes midis fizikut dhe kontabël në vlerën 45 371 978 lekë, nga e cila llog.218 në tepri në vlerën 20 493 647 lekë, llog 214 në mungesë për vlerën 19 837 827 lekë dhe llog. 212 në mungesë për vlerën 5 040 504 lekë.
11. Drejtoria Ekonomike, për rastet e ekzistencës së mospërputhjes midis fizikut dhe kontablit të llog. 214 me vlerë 19 837 827 lekë, të bëhen sistemimet dhe rregullimet përkatëse në kontabilitet dhe pasqyrat financiare. Të nxirren si debitorë të gjithë personat përgjegjës duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej 19 837 827 Lekë.

